



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 854 / 1 prot.

Tiranë më 17.5.2018

Lënda: Përgjigje në kuadër të kërkesës për mendim mbi procedurën e pajisjes së institucionit me sistem sigurie CCTV.

GJYKATËS SË APELIT DURRËS

Durrës

Paraprakisht, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerëson angazhimin dhe seriozitetin e treguar në kuadër të respektimit të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Nëpërmjet instalimit dhe përdorimit të sistemit të kamerave, në ambientet e sekretarisë gjyqësore dhe arshivës së gjykatës, përpunohen të dhëna personale të stafit të Gjykatës së Apelit dhe çdo personi që hyn në ambientet e survejuara. Në këtë kuadër në cilësinë e kontrolluesit lind nevoja e respektimit të detyrimeve që parashikon ligji i sipërcituar por, më konkretisht Udhëzimi nr.3 datë 05/03/2010 mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e videosurvejimit në ndërtesa dhe mjediset e tjera" (mund ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare www.idp.al).

Në parim, instalimi i sistemit të kamerave për qëllime sigurie konsiderohet i ligjshëm por, mbani në vëmendje respektimin në çdo rast të parimeve dhe detyrimeve të mbrojtjes së të dhënave personale të sanksionuara në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar (neni 5,6).

Ju sugjerojmë që me vendosjen e sistemit të videosurvejimit të keni në vëmendje masat e sigurisë së të dhënave, aksesin e kufizuar në bazën e të dhënave të sistemit të kamerave, pozicionin e kamerave (vetëm në përputhje me qëllimin e përpunimit), afatin e mbajtjes së xhirimeve dhe vendosjen e tabelave informuese për kamerat sipas formatit të miratuar nga Zyra e Komisionerit nëpërmjet Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 të sipërcituar.

Gjithashtu, nga verifikimi në regjistrin elektronik të njoftimeve rezulton që e keni realizuar detyrimin për njoftim por, nuk keni njoftuar për përpunim e të dhënave

nëpërmjet sistemit të videosurvejimit. Në këtë kuadër lind nevoja që në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar të kryeni përditësimin e njoftimit (referuar rubrikës 4 “Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen” dhe rubrikës 6 “Qëllimi i përpunimit”).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

